



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR ZVICRËN

1. Informacion bazë

Kryeqyteti:	Bern
Popullsia:	7,591,400
Sipërfaqja:	41,285 km ²
Monedha:	Franga zvicerane (CHF), (1€ = 1.61 CHF)
Niveli i papunësisë:	3.3 %

2. Kushte të përgjithshme të hyrjes dhe informacioni për vizë

Nëse po planifikoni një udhëtim në Zvicër, prisni vizitë nga jashtë apo do të doni të ftoni vizitorë nga jashtë në Zvicër, informacioni i mëposhtëm mund t'ju ndihmojë.

Në 12 dhjetor 2008 marrëveshja e Shengen hyri në fuqi dhe në Zvicër. Që nga kjo datë, për të hyrë në Zvicër duhet vizë Shengen (përfundojnë kontrollet e brendshme në aeroportet e Zvicrës në datë 29 mars 2009).

Bashkëpunimi i Dublinit¹ siguron që azilkërkuesit të bëjnë vetëm një aplikim për azil brenda zonës së Dublinit. Kriteret e Dublinit përcaktojnë se cili vend është i ngarkuar për ndjekjen e procedurave të azilit dhe kështu siguron një shpërndarje konstante dhe ndarje të përgjegjësive. Marrëveshja e Dublinit zyrtarisht hyri në fuqi në 1 Mars 2008 ndërsa praktikisht ajo ka hyrë në fuqi në datë 12 dhjetor 2008.

Parakushtet për të hyrë

Shtetasit e huaj për të hyrë në Zvicër kanë nevojë për një dokument udhëtimi të vlefshëm dhe të pranueshëm. Gjithashtu, vizë kërkohet për personat nga vendet jo evropiane. Për qëndrim të shkurtër në Zvicër (maksimumi 3 muaj brenda 6 muajsh), viza zvicerane është zëvendësuar me vizën Shengen. Për qëndrim më të gjatë se 6 muaj, kërkohet vizë zvicerane për personat nga vendet jo evropiane. (http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/rechtsgrundlagen/weisungen_und_kreisschreiben/Weisungen_Visa.Par.0026.File.tmp/Annex%201%20List%201-IDandVisa%20Provisions-for-Switzerland-According-to-Nationality-020309.pdf)

¹ http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/schweiz_-_eu/personenfreizuegigkeit/factsheets.Par.0047.File.tmp/FS-%20Dublin-d.pdf; member states: the 15 old EU states (Belgium, Danmark, Germany, Finland, France, Greece, Ireland, Italy, Luxembourg, Netherlands, Austria, Portugal, Sweden, Spain, United Kingdom; GB, IR and DK in special agreement), the 12 new member states (Czech Republik, Cyprus, Estonia, Latvia, Lithuania, Hungary, Malta, Poland, Slovenia, Slovakia) plus Norway and Island.

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: "Ngritja e Kapaciteteve, Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimi për Nxitjen e Migracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Bashkimi Europian dhe bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin dhe Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë/Zyra Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qeveria e Lihtenshtein



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees



GOVERNMENT
OF LIECHTENSTEIN

http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/schweiz_-_eu/personenfreizuegigkeit/factsheets/2008.Par.0010.File.tmp/081211-FS1-d.pdf .

Për më tepër, duhet të keni në dispozicion fonde të mjaftueshme ose të siguruar me mjete ligjore për të mbuluar koston e jetesës gjatë kalimit transit apo qëndrimit në Zvicër. Zyra Federale Zvicerane për Migracionin (FOM), misionet e huaja zvicerane dhe autoritete policore të kantoneve për të huajt do të sigurojnë me kënaqësi informacion për kushtet themelore për të hyrë në Zvicër (www.bfm.admin.ch).

Arsyeja dhe kohëzgjatja e qëndrimit

Vizitorët e huaj që kanë hyrë në Zvicër në përputhje me rregullat përkatëse dhe që nuk fillojnë ndonjë lloj punësimi nuk kanë nevojë për leje qëndrimi nëse kohëzgjatja e qëndrimit të tyre nuk i kalon tre muaj. Qëndrimi i tyre nuk duhet të kalojë një total prej tre muajsh brenda një periudhe gjashtë mujore. Individë që kanë nevojë për vizë duhet të zbatojnë kohëzgjatjen e qëndrimit të specifikuar në vizat e tyre.

Shtetas të huaj që synojnë të punësohen në Zvicër kërkohet që të aplikojnë për një leje garancie ose personalisht ose nëpërmjet punëdhënësit të tyre pavarësisht faktit nëse kanë nevojë për vizë për të hyrë në Zvicër apo jo. Në rast të një kërkese për të marrë vizë, garancia jepet nëpërmjet lëshimit të vizës.

Rregulla për regjistrimin

Kushdo që siguron akomodim për shtetas të huaj në këmbim të një pagesë është i detyruar të njoftojë menjëherë autoritetet. Nëse shtetasit e huaj akomodohen falas nuk ka detyrim për të njoftuar autoritete, duke ju nënshtruar dispozitave përgjithësisht më të rrepta të kantoneve. Shtetasit e huaj duhet të paraqiten menjëherë tek autoritetet e kantoneve apo komunale përgjegjëse nëse largimi i tyre brenda periudhës së qëndrimit që ju është caktuar nuk është i mundur.

Deklaratë sponsorizimi

Misionet e huaja zvicerane mund të lëshojnë një vizë në varësi të një deklaratë sponsorizimi nëse aplikanti nuk ka fonde të mjaftueshme financiare ose nëse kjo gjë është e dyshimtë. Garanti angazhohet për të mbuluar kostot e pambuluara deri në 30,000 CHF për shpenzime jetese, duke përfshirë aksidente dhe sëmundje. Nëse një deklaratë sponsorizimi është i nevojshëm, misioni i huaj zviceran përgjegjës do të sigurojë për vizitorin e huaj formularët dhe udhëzimet e nevojshme. Një deklaratë i miratuar sponsorizimi nuk jep garanci për lëshimin e vizës.

Tarifat

Shqyrtimi i një deklaratë sponsorizimi nga autoritetet e kantoneve i nënshtrohet një tarife. Si rregull, kjo tarifë administrative paguhet paraprakisht me anë të faturave të veçanta të depozitimit.

Siguracion udhëtimit

Pavarësisht nga fakti nëse është dorëzuar një përjashtim nga përgjegjësia, autoritetet kompetente kërkojnë një policë sigurimi për udhëtimin e kthimit nëse kostoja e një operacioni shpëtimi, udhëtimit të kthimit për arsye shëndetësore, asistencë mjekësore në një urgjencë apo kujdes shëndetësor urgjent në rastin e një aksidenti apo sëmundjeje të papritur gjatë qëndrimit të personit nuk mbulohet me mjete të tjera. Mbulimi minimal i sigurimit është CHF 50,000.

Fletë informacioni për të hyrë në Zvicër:

http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/einreise/merkblatt_einreise.Par.0004.File.tmp/merkblatt_0308-e.pdf

Formulari i aplikimit për vizë

Formularët për t'u shkarkuar dhe plotësuar *online*

Të gjithë formularët:

<http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/einreise/visumantragsformular.html>

Udhëzime

- Gjermanisht – frëngjisht - italisht - anglisht
http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/einreise/visumantragsformulare.Par.0013.File.tmp/a_infoblattBFM_d_f_i_e.pdf
- Gjermanisht - frëngjisht - italisht - shqip
http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/einreise/visumantragsformulare.Par.0020.File.tmp/Infoschreiben07_albanisch_d_f_i_e.pdf

Informacioni në lidhje me Aplikimin për Vizë

Ju lutemi vini re që:

- Aplikimi për vizë duhet të dorëzohet në ambasadën/konsullatën zvicerane në vendin tuaj të qëndrimit.
- Një aplikim për vizë që nuk dorëzohet në ambasadën/konsullatën zvicerane të vendit tuaj të qëndrimit mund të refuzohet nëse janë të paqarta arsyet për dorëzimin e aplikimit për vizë në ambasadë/konsullatë tjetër zvicerane
- Duhet të keni burime të mjaftueshme financiare për të mbuluar koston e jetesës në Zvicër; si rregull, një shumë prej 100 CHF në ditë konsiderohet e mjaftueshme
- Ambasada/konsullata zvicerane mund të kërkojë një deklaratë garancie
- Një vizë pa autorizim të shprehur nga autoritetet përgjegjëse lejon vetëm qëndrim të përkohshëm në Zvicër
- Ju mund të hyni në Zvicër vetëm gjatë periudhës së specifikuar në vizën tuaj.
- Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit tuaj në Zvicër është specifikuar në vizë.
- Nuk mund të filloni punë gjatë qëndrimit në Zvicër as të filloni studime që kalojnë një periudhë tre mujore pa lejen e nevojshme

Ekstrakt nga Urdhri për Hyrjen dhe Regjistrimin e të Huajve

Deklaratë garancie

- Autoritetet përgjegjëse që japin leje mund të kërkojnë një deklaratë garancie, të firmosur nga një person juridik apo fizik në gjendje të mirë financiare në Zvicër, si mjet kontrolli mbi rrethanat e vizitës së një të huaji
- Garancia mund të jepet nga shtetas zviceranë; ose shtetas të huaj që kanë leje qëndrimi

Aplikimi për vizë

- Një shtetas i huaj kërkohet të dorëzojë një aplikim për vizë me anë të formularit të specifikuar për aplikim tek Misioni i Huaj Zviceran që mbulon vendin e tij/saj të qëndrimit. Zyra Federale Zvicerane për Migracionin përcakton çdo përjashtim.
- Aplikimi për vizë duhet të shoqërohet me dokument udhëtimi, si dhe dokumente të tjera, nëse kërkohet, që tregojnë qartë qëllimin dhe rrethanat e qëndrimit apo kalimit transit të planifikuar
- Shtetasit e huaj kërkohet të plotësojnë kushtet e mëposhtme, përveç rregullave të hyrjes sipas nenit 1 të OEArr (Urdhrit për Hyrjen dhe Regjistrimin e të Huajve), për një vizë transit.
 - a. të kenë dokument udhëtimi dhe vizë që i japin të drejtën mbajtësit të kalojë transit dhe të hyjë në vendin e destinacionit;
 - b. të sigurojnë fakte për kalimin transit në aeroport me anë të një bilete të vlefshme
- për destinacionin e tyre përfundimtar.

Të drejta ligjore

- Nëse një vizë është refuzuar apo anuluar, Zyra Federale për Migracion nxjerr një vendim, që i nënshtrohet një tarife, me kërkesë të aplikantit.
- Kërkesa do të shqyrtohet vetëm pasi të jetë bërë paraprakisht pagesa.
<http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/einreise/visumantragsformular.html>

Kërkesat për vizë për në Zvicër (dhe Lihtenshtein)

http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/rechtsgrundlagen/weisungen_und_kreisschreiben/Weisungen_Visa.Par.0022.File.tmp/anh1-liste1_vorschriften_20090529-d.pdf

http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/rechtsgrundlagen/weisungen_und_kreisschreiben/Weisungen_Visa.Par.0021.File.tmp/anh1-liste2_vorschriften-besonderes_20090406-d.pdf

(only in French, German and Italian)

Procedura për vizë për turizëm, biznes dhe vizitë

Për qëndrim maksimumi tre muaj; nuk lejohet punë apo veprimtari fitimprurëse. Ju lutemi të vini re që aplikimi për vizë duhet t'i dorëzohet ambasadës/konsullatës zvicerane përgjegjëse për vendin tuaj të qëndrimit. (shihni 2.5.3.)

Ju lutemi dorëzoni personalisht tek kjo Ambasadë (të paktën një javë përpara nisjes):

- 1 formular aplikimi të plotësuar dhe firmosur nga mbajtësi i pasaportës (http://www.bfm.admin.ch/etc/medialib/data/migration/einreise/visumantragsformulare.Par.0001.File.tmp/visumantrag07_a.pdf)
- 1 fotografi pasaporte të padëmtuar dhe të kohëve të fundit
- Pasaportë ose dokument udhëtimi të vlefshëm për tre muaj pas qëndrimit të planifikuar në Zvicër
- leje qëndrimi të vlefshme pas përfundimit të qëndrimit
- Një vizë Shengen të vlefshme të paktën për dy hyrje për kthimin nëse keni Kartë Portokalli (attestation d'immatriculation)
- vërtetim të mjeteve të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e qëndrimit, si vërtetim page nga muaji i fundit, deklaratë bankare të një llogarie, llogari kursimi, karta krediti, çek udhëtimi etj. (kërkesa minimale CHF 100/70 EUR për çdo ditë qëndrimi në Zvicër)

Të tjera për:

Vizë për turizëm http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/refs/eur/vbel/ref_visinf/visbel.html

- rezervim hoteli, apartamenti apo shtëpi pushime me adresë të plotë
- biletë udhëtimi; konfirmim i paketës së udhëtimit nga agjenti i udhëtimit; regjistrim dhe siguracion makine, autorizim nga pronari (nëse vlen) dhe rezervim hoteli
- për studentë: letër nga shkolla apo universiteti që konfirmon pjesëmarrjen në udhëtim me data dhe adresën në Zvicër
- për nxënës (nën 18 vjeç) që janë në udhëtim nga shkolla: një autorizim të përbashkët nga prindërit të legalizuar nga një komunë përgjegjëse belge

Vizë për biznes

- Vërtetim të lidhjeve ekzistuese tregtare, një ftesë nga një kompani apo partner biznesi në Zvicër duhet t'i dërgohet ambasadës me faks

Vizë për vizitorë

- ftesë e dërguar me faks në Ambasadë nga një rezident i Zvicrës që tregon se të gjitha shpenzimet e aplikantit gjatë periudhës së specifikuar të qëndrimit në Zvicër do të mbulohen nga pritësi, me adresë të plotë, shoqëruar me një kopje të kartës zvicerane të identitetit apo pasaportës, ose kartës së rezidentit në Zvicër nëse personi nuk është shtetas Zviceran
- sipas situatës, është e nevojshme një deklaratë garancie të miratuar nga policia e kantonit për të huajt nga kantoni ku pritësi është rezident. Formularët e garancisë mund të merren në këtë Ambasadë.

Vizë transiti

Një vizë transit vetëm lejon mbajtësin e saj që të kalojë përmes Zvicrës për 24 orë pa ndaluar.

- bileta e udhëtimit (shihni vizën për turizëm)

Vizë transiti në aeroport

Një vizë transiti në aeroport lejon mbajtësin që të qëndrojë në aeroport deri në 48 orë. Një vizë transiti kërkohet në çdo rast për persona pa shtetësi. Mbjtësit e pasaportave të Afganistanit, Angolës, Bangladeshit, Republikës Demokratike të Kongos, Etiopisë, Ganës, Guinesë, Indisë, Iranit, Libanit, Nigerisë, Pakistanit, Sierra Leones, Sri Lankës dhe Turqisë kanë nevojë për vizë transiti nëse nuk kanë vizë ose leje qëndrimi për një vend të BE-së, Norvegji, Islandë, Kanada ose SHBA ose nëse nuk udhëtojnë me pasaportë diplomatike, shërbimi ose speciale. Të gjitha shtetasit e tjerë nuk kanë nevojë për vizë transiti.

Kushtet për vizë transit janë që pasagjeri duhet:

- të fluturojë me një linjë ajrore të licencuar në Zvicër
- të jetë në gjendje të vazhdojë udhëtimin e tij/saj, duke pasur të gjitha vizat e nevojshme për destinacionin
- të ketë një biletë të vlefshme dhe një vend të rezervuar për gjithë udhëtimin deri në destinacion

Vizë për punë ose studime ose bashkim familjar

- 2 formularë shtesë aplikimi (tre gjithsej)
- 2 fotografi shtesë (tre gjithsej)
- Kontratën e punës ose dokument që vërteton regjistrim në një institucion shkollor (shkollë apo universitet)
- Një curriculum vitae
- Një dëshmi të vlefshme për sjellje të mirë (vlefshmëria më pak se tre muaj)
- Për bashkim familjar, kontratën e punës ose dokument që vërteton regjistrimin në një institucion arsimor të personit përgjegjës për pjesën tjetër të familjes

Ky aplikim për vizë duhet të dorëzohet të paktën dy muaj përpara fillimit të punës apo studimeve në Zvicër për autorizim.

Vizë pas autorizimit (punë, studime, apo bashkim familjar)

- dokumenti i autorizimit i dorëzuar nga autoriteti federal zviceran ose autoritetet e kantoneve (nuk kërkohet vërtetim i mjeteve financiare)

Tarifat

36 EUR që paguhen në dorë. Tarifat nuk janë të kthyeshme në rast të refuzimit të vizës.

Pasaportat zyrtare (diplomatike, shërbimi ose të veçanta)

Aplikimi për vizë duhet të shoqërohet me një notë verbale ose letër nga Ambasada, Komisioni i Lartë, Konsullata apo Organizata Ndërkombëtare e aplikantit. Kjo notë verbale duhet të përmbajë qëllimin e udhëtimit në Zvicër, adresën e plotë në Zvicër dhe datën e hyrjes dhe daljes nga Zvicra.

Shënim i rëndësishëm për diplomatët dhe të asimiluarit

Për disa shtetësi, kjo vizë mund të jepet vetëm pas autorizimit me shkrim nga autoritetet zvicerane. Vonesa në dhënien e vizës e parashikuar për 24 orë nuk mund të respektohet gjithmonë. Disa dokumente shtesë duhet të dërgohen në Zvicër. Për më shumë informacion, ju lutemi të kontaktoni seksionin për vizat.

Kërkesë akreditimi në Zvicër

Vetëm për diplomatët dhe të asimiluarit që kërkojnë akreditim në Zvicër:

- mbushni një formular aplikimi në tre kopje
- 7 fotografi
- një notë verbale të Ambasadës ose Misionit të interesuar që të përmbajë funksionin e ushtruar në Zvicër nga diplomatët apo të asimiluarit dhe datën e nisjes.
- plotësoni pyetësorit për të sapoardhurit

(<http://www.eda.admin.ch/etc/medialib/downloads/edactr/bel/embbbru.Par.0006.File.tmp/questionnaire%20english.pdf>)

Ambasada ose Misioni i huaj në Zvicër duhet të njoftojë gjithashtu Shërbimin e Protokollit në Bern ose Misionin Zviceran në OKB për kërkesën e akreditimit. Një kopje e kësaj note verbale duhet të shtohet në dosjen për vizë.

Vonesa në marrjen e një vize zvicerane

Vonesa në marrjen e një vize zvicerane do të varet nga përgjigja e autoriteteve përgjegjëse zvicerane. Si rregull i përgjithshëm, vizat, sipas situatës, jepen të paktën 24 orë pas datës së aplikimit (ose ditën tjetër të punës). Vetëm një dosje e plotësuar e dorëzuar nga ora 9.00 – 11.00 paradite do të pranohet. Tarifa 36 € nuk do të kthehet, për asnjë arsye, edhe nëse viza refuzohet.

Informacioni shtesë për vende/territore specifike

Shqipëria: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/valb/ref_visinf/visalb.html

Bosnja dhe Hercegovina: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vbih/ref_visinf/visbih.html

Kroacia: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vhrv/ref_visinf.html

Kosovë: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vkos/lopri/vispri.html>

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë:

http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vmkd/ref_visinf/vismkd.html

Mali i Zi: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vmon/ref_visinf.html

Serbia: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vsrb/ref_visinf/vissrb/visreq.html

3. Imigracioni për qëllime punësimi

Zvicra ka një sistem të dyfishtë për t'ju dhënë shtetasve të huaj të drejtë për t'u futur në tregun e punës zviceran. Personave nga BE ose shtetet anëtare të EFTA-s, pavarësisht nga kualifikimet e tyre, u jepet lehtësisht e drejta për të hyrë në tregun zviceran të punës sipas Marrëveshjes për Lëvizjen e Lirë të Personave. Me vendim të Këshillit Federal, punëtorë nga të gjitha shtetet e tjera- shtete të treta, siç quhen këtu- pranohen me numër të kufizuar në tregun e punës në Zvicër, nëse aftësitë e tyre nevojiten menjëherë në Zvicër dhe nëse ata janë të kualifikuar.

Qëndrimi dhe punësimi në Zvicër i shtetasve të BE-së/EFTA-s²

Prezantimi i lëvizjes së lirë të persona bëhet gradualisht dhe kjo është arsyeja pse masa kalimtare dhe rregulla specifike zbatohen akoma për disa shtete (Poloni, Republika Çeke, Sllovakia, Hungari, Estoni, Letoni, Lituani dhe Slloveni)

Kantonet janë përgjegjëse për dhënien e lejeve. Për informacion të hollësishëm për procedurën e aplikimit (Ku të aplikoni, cilët formularë të plotësoni, sa kohë do të duhet etj), ju lutemi të kontaktoni autoritetet përgjegjëse të kantoneve.

http://www.bfm.admin.ch/bfm/de/home/die_oe/kontakt/kantonale_behoerden/adressen_kantone_und.html

Për më shumë informacion, shihni gjithashtu:

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/eu_efta-angehoerige.html

Qëndrimi dhe punësimi në Zvicër i shtetasve që nuk janë nga vendet e BE-së/EFTA-s³

Baza ligjore për hyrjen e shtetasve të huaj në tregun zviceran të punës

Kriteret e pranimit përfshihen në Aktin Federal për Shtetasit e Huaj (AuG) dhe në Vendimin për Pranimin, Qëndrimin dhe Punësimin.

Për më shumë informacion shihni:

² http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/schweiz_-_eu/aufenthalt_der_eu.html

³ http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige.html

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/grundlagen_zur_arbeitsmarktzulassung.html

Për informacion për politikat e pranimit të Zvicrës, shihni:

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/zulassungspolitik.html

Procedura⁴

Dorëzimi i aplikimit: Punëdhënësi (pronari i ndërmarrjes) dorëzon dokumentet e duhura të aplikimit tek shërbimi i punësimit të kantonit. Sipas rastit apo kantonit që është përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve, aplikimet i dorëzohen agjencisë së migracionit të kantonit në fjalë. Punëtorëve nga shtete që i nënshtrohen kërkesës për vizë u kërkohet të aplikojnë për vizë tek përfaqësitë diplomatike zvicerane jashtë vendit

Shqyrtimi i aplikimit: Shërbimi i punësimit i kantoneve shqyrton aplikimet sipas udhëzimeve ANAG dhe merr një vendim paraprak. Aplikimet e miratuara nga kantoni duhet t'i dorëzohen Zyres Federale për Migracion për miratim përfundimtar.

Zyra Federale për Migracion (FOM) shqyrton aplikimet sipas kriterëve që zbatohen në të gjithë Zvicrën. Aplikanti, punëdhënësi dhe zyrat e kantoneve marrin një vendim zyrtar me shkrim nga Zyra e Migracionit. Vendimi i nënshtrohet një tarife, që paguhet nga punëdhënësi dhe nuk e autorizon aplikantin të hyjë në Zvicër.

Dhënia e vizës: Autoriteti i kantonit për migracionin këshillon (me miratimin e FOM kur bëhet fjalë për persona nga shtete që i nënshtrohen kërkesës për vizë) përfaqësinë përkatëse diplomatike zvicerane në lidhje të drejtpërdrejtë elektronike që të japë vizën. Aplikantëve u kërkohet të marrin vizën në atë përfaqësi specifike zvicerane

Regjistrimi: Punëmarrësi regjistrohet në zyrën e regjistrimit të rezidentëve jo më vonë se 14 ditë pas hyrjes në Zvicër. Vetëm atëherë ai lejohet të fillojë punë.

Për dokumentet e nevojshme të aplikimit, shihni listën:

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/gesuchsunterlagen.html

FAQs:

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/faq_-_haeufig_gestellte.html

Më shumë informacion për të punuar në Zvicër:

<http://www.ch.ch/private/00054/00055/00543/00561/index.html?lang=en>

http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/links_rund_um_das.html

Faqet kryesore në internet për të kërkuar punë

<http://www.jobs.ch/?c=1>

[http://www.jobwinner.ch/\(lduvs245txu4myyd3qcla4e5\)/home.aspx](http://www.jobwinner.ch/(lduvs245txu4myyd3qcla4e5)/home.aspx)

<http://www.topjobs.ch/JS24Web/Public/Default.aspx?lng=en&wl=2>

<http://www.jobscout24.ch> (*Faqe interneti vetëm në gjermanisht dhe frëngjisht*)

Kuotat dhe marrëveshjet dypalëshe me vende/territore specifike

Shqipëria: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/valb/bilalb.html>

Bosnja dhe Hercegovina: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vbih/bilbih.html>

Kroacia: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vhrv/bilkro.html>

Kosova: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vkos/ref_visinf.html

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë:

<http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vmkd/bilmaz.html>

Mali i Zi: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vmon/bilmoo.html>

Serbia: http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vsrb/ref_visinf.html

⁴ http://www.bfm.admin.ch/bfm/en/home/themen/arbeit/nicht-eu_efta-angehoerige/verfahrensablauf.html

4. Imigracioni për qëllime studimi

Arsimi në Zvicër⁵

Zvicra e ndan sistemin arsimor në nivel të parë, të dytë dhe të tretë. Në çdo nivel mundësitë për të huajt janë të hapura.

Nivelet parësore dhe i mesëm (të para) janë fazat e **arsimimit të detyruar** që zgjat nëntë vjet. Niveli i dytë i mesëm është faza pas arsimimit të detyruara. Më shumë se 50% e të rinjve zgjedhin **trajnim profesional**, që zgjat deri në katër vjet.

Faza e tretë mbulon universitetet dhe trajnimin e lartë profesional.

- Zvicra ka universitete që sigurojnë arsimim të përgjithshëm dhe universitete të shkencave të aplikuara
- Trajnimi i lartë profesional sigurohet nga shkolla më të larta teknike dhe shkolla teknike, që çojnë në marrjen e certifikatave profesionale dhe diplomave profesionale më të larta
- Arsimimi universitar sigurohet nga më poshtë:
- 10 universitete në kantone
- 2 Institute Federale të Teknologjisë
- 7 Universitete të Shkencave të Aplikuara
- Arsimimi në nivel universitar ndjek sistemin diplomë universitare-Master. Zvicra përpiqet të lehtësojë lëvizjet ndërmjet universiteteve dhe në 1999 nënshkroi të ashtuquajturën deklaratë të Bolonjës. Reformat që synojnë standardizimin e strukturës së studimeve dhe të diplomave duhet të përfundojnë deri në 2010.

Për më shumë informacion shihni gjithashtu: <http://www.ch.ch/private/00060/index.html?lang=en> dhe faqet e internetit të universiteteve specifike (seksioni 4.4)

Kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të studentëve

Kontaktoni universitetin që keni zgjedhur. Procedura e para-aplikimit për disa universitete mund të bëhet *online*. Pasi të keni marrë konfirmimin që jeni pranuar nga një universitet zviceran, ju lutemi të kontaktoni ambasadën zvicerane në vendin tuaj për informacion për formalitetet e hyrjes në Zvicër. Do të duhet të tregoni që keni mjetet e duhura financiare për të mbajtur veten gjatë studimeve.

Sapo të mbërrini në Zvicër, duhet të kërkonte një lejë qëndrimi nga Policia për të Huajt. Dokumentet e mëposhtme janë të nevojshme:

- Pasaportë të vlefshme dhe një vizë nëse është e nevojshme
- Konfirmim që jeni pranuar nga një universitet zviceran
- Një garanci për mjete të mjaftueshme financiare për të mbajtur veten gjatë studimeve. Shihni seksionin për punën dhe studimet
- Vërtetim të një adrese të përhershme në Zvicër
- Leja juaj e qëndrimit duhet të rinovohet çdo vit. Leja e qëndrimit do të lëshohet vetëm nëse janë të garantuara mjetet tuaja financiare. Gjithashtu, do të duhet të rinovoni çdo vit lejen e qëndrimit. Studentë të huaj lejohet të punojnë deri në 15 orë në javë përsa kohë që nuk shtyhet kohëzgjatja e studimeve.

Bursat

Bursa për studentë të huaj në Zvicër

Qeveria zvicerane ofron bursa për studentët e huaj dhe artistët në bazë të reciprocitetit ose brenda kuadrit të bursave në vende të ndryshme. Bursat jepen për kandidatë pasuniversitare nga vendet industriale dhe vendet në zhvillim. Kandidatët, në radhë të parë, duhet të mësojnë nga autoritetet e

⁵ <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/afri/vsdn/infoch/chwoed.html>

vendit të tyre nëse kanë të drejtë për bursë nga qeveria apo duhet t'i drejtohen ambasadës ose konsullatës zvicerane (<http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs.html>) në vendin e tyre të origjinës. Një listë e vendeve dhe informacioni mëtejshëm për bursat nga qeveria, si për shembull kërkesat për aplikim, kohëzgjatja e bursës, shuma e bursës, procedura e aplikimit etj mund të gjendet në <http://www.sbf.admin.ch/eskas-e.html>

Për të mësuar nëse universitetet zvicerane ofrojnë bursa për studentë të huaj, kandidatët këshillohen të kontrollojnë tek qendrat e lëvizshmërisë të universiteteve zvicerane <http://www.erasmus-online.ch/international-offices.html> ose të vizitojnë <http://www.swissuniversity.ch/info> (Bashkëpunimi Ndërkombëtar).

Bursat pasuniversitare

Në një program të veçantë alkimi, qeveria zvicerane, nëpërmjet Komisionit Federal për Bursa për Studentët e Huaj (FCS) po ofron 15-20 bursa për studentë nga Europa Qendrore dhe Lindore për vitin akademik 2009/2010. Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimeve tek ambasada zvicerane kompetente është 22 nëntor 2008. Aplikantë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia janë të pranueshëm për të aplikuar.

Për më shumë informacion shihni:

http://www.eda.admin.ch/etc/medialib/downloads/edactr/alb.Par.0007.File.tmp/Notice_Eastern%20Europ_e_english_2008-2009.pdf

Informacion specifik për vendet:

Shqipëria: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/valb/embtir/educ.html>

Maqedonia: <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/eur/vmkd/embsko/schlr.html#0001#0001>

Serbia: <http://www.eda.admin.ch/eda/de/home/rebs/eur/vsrb/embbel/schola.html>

Universitetet dhe kolegjet kryesore në Zvicër⁶

Në Zvicër jo vetëm që është e mundur të studioni në tre gjuhë zyrtare (gjermanisht, frëngjisht, italisht), por gjithnjë e më shumë edhe në anglisht. Universitetet e Baselit, Bernit, Zyrihut, Lucernes dhe St Gallen janë në pjesën gjermanisht folëse të Zvicrës, siç është Instituti Federal i Teknologjisë në Zyrih (ETH në Zyrih). Pjesa frëngjisht folëse ka universitete në Gjenevë, Lausanne dhe Neuchâtel dhe Institutin e dytë Federal të Teknologjisë që është në Lausanne (EPFL).

Universiteti Fribourg është në një kanton dygjuhësh dhe ofron kurse në Gjermanisht dhe frëngjisht. Universiteti italisht folës i Zvicrës italiane ndodhet në Lugano.

Të gjithë universitetet ofrojnë një numër gjithnjë në rritje të programeve Master që jepen pjesërisht ose krejtësisht në anglisht. Institucione të tjera me natyrë universitare janë kolegjet e ndryshme të mësimdhënies, Instituti i Lartë i Studimeve Ndërkombëtare në Gjenevë, Shkolla e Lartë Zvicerane e Administratës Publike në Lausanne dhe Universiteti pasuniversitar Kurt Bösch në Sion.

Universitete në kantone

- Basel (BS): http://www.unibas.ch/index.cfm?o_lang_id=2
- Bern (BE): <http://www.unibe.ch/eng>
- Fribourg (FR): <http://www.unifr.ch/home/welcomeD.php> (Faqe interneti vetëm në gjermanisht dhe frëngjisht)
- Geneva (GE): http://www.unige.ch/international/index_en.html
- Lausanne (VD): http://www.unil.ch/central/page2192_en.html
- Lucerne (LU): <http://www.unilu.ch/eng/start.aspx>
- Lugano (TI): <http://www.unisi.ch/en/index.htm>
- Neuchâtel (NE):
<http://www2.unine.ch/Jahia/site/prospectivestudent/op/preview/lang/en/pid/22573>
- St. Gallen (SG):

⁶ <http://www.eda.admin.ch/eda/en/home/rebs/afri/vsdn/infoch/chwoed.html>

<http://www.unisq.ch/hsgweb.nsf/wwwPubhomepage/webhomepageeng?opendocument>
[Zurich \(ZH\): http://www.uzh.ch/index_en.html](http://www.uzh.ch/index_en.html)

- Institute Federale të Teknologjisë
- EPFL Lausanne: <http://www.epfl.ch/index.en.html>
- ETH Zurich: http://www.ethz.ch/index_EN
- Universitete të Shkencave të Aplikuara
- Bern: <http://www.bfh.ch> (Faqe interneti vetëm në gjermanisht dhe frëngjisht)
- Zvicra Lindore (GR, SG, ZH): <http://www.fho.ch/content.php?pg=11&id=12>
- Lucerne: <http://www.international.hslu.ch/en/indexinternational>
- Zvicra Veri-perëndimore (AG, BS, BL): http://www.en.fhnw.ch/?set_language=en
- Zvicra Jugore (TI): <http://www.supsi.ch/?page=English>
- Zvicra Perëndimore (FR, GE, JU, NE, VD, VS):
<http://www.hes-so.ch/default.asp?Language=EN>
- Zurich: <http://www.zfh.ch/d> (Faqe interneti vetëm në gjermanisht)
- Liechtenstein: <http://www.hochschule.li/english>

Kërkesa për pranim⁷

Një certifikatë e njohur në nivel federal për mbarimin e shkollës (Maturë) ose certifikatë e huaj ekuivalente (normalisht ekuivalente me certifikatë kolegji) i jep të drejtë mbajtësit të studiojë në nivel universitar. Pranimi varet nga universiteti specifik (ju lutem kontaktoni universitetin, shihni lidhjen më sipër). Në çdo rast, njohuria e mirë e gjuhës së mësimdhënies është parakusht.

Viti akademik zakonisht në Zvicër fillon në shtator. Aplikantët duhet të kontaktojnë në kohë universitetin e përzgjedhur të tyre. Universitetet mund të sigurojnë informacion për tarifën dhe grantet. Përveç tarifës, studentët pritet të shpenzojnë CHF 16'000-24'000 për shpenzimet e jetesës, sipas kërkesave të tyre.

Programi për studentët e huaj

Ju lutemi të kontaktoni universitetet (shihni listën në 4.4.) dhe shihni programin e pranimeve (4.3.2.).

Faqe të tjera interneti

